

Prof. dr. Fehmi REXHEPI

Selim LOKAJ – Shkodran YMERAJ

“Fillimi i jetësimit të Kushtetutës së Kaçanikut në komunën e Deçanit”, Monografi për hartuesit e Statutit të Komunës së Deçanit në bazë të Kushtetutës së Kaçanikut, botoi Lidhja e Historianëve të Kosovës “Ali Hadri” dega Deçan dhe FOCUS, Prishtinë 2008, fq. 104.

Botimi i një libri është një e mirë e përgjithshme dhe një eveniment kulturor që duhet të shënohet dhe që duhet të mbahet mend. Por botimi i një monografie siç është vepra, *Fillimi i jetësimit të Kushtetutës së Kaçanikut në komunën e Deçanit* është një sukses i veçantë dhe një e arritur e jashtëzakonshme jo vetëm për Deçanin e autorët por edhe më gjerë sepse synon të përjetësojë një kohë dhe një angazhim të veçantë të një grupi veprimtarësh e atdhetarësh të cilët kishin për ideal që në praktikë të kontribuonin në ndërtimin dhe institucionalizimin e shtetit të Kosovës në një kohë të mprehtë të mbushur me plotë sfida.

Autorët e kësaj monografie edhe pse pa ndonjë përvojë në shkrime dhe publikime të tilla me një mjeshtëri të veçantë dhe me një entuziazëm të jashtëzakonshëm ia kanë dalë me sukses të pasqyrojnë tërë kompleksitetin e zhvillimit të ngjarjeve dhe të situatës së vështirë e sfiduese në të cilën gjendej Kosova në përgjithësi dhe Komuna e Deçanit në veçanti në dekadën e fundit të shekullit të kaluar, në atë dekadë kur populli ynë po zhvillonte Lëvizjen Çlirimtare në rrethana të vështira dhe po organizohej në një luftë të pa barabartë kundër pushtuesit serb, luftë e cila po zhvillohej për jetë a vdekje.

Ky libër është një monografi e mirëfilltë që shërben për ruajtjen e kujtesës sonë historike. Është përkujtesë për një periudhë të

mbushur përplot sfida e ngjarje me peshë për të tashmen e të ardhmen tonë. Është monografi për një gjeneratë idealistësh të cilët pa marrë parasysh rreziqet e shumta vepruan dhe punuan me përkushtim duke lënë gjurmë në një periudhë të historisë tonë më të re.

Këtu lexuesi mund të gjejë burime dhe të dhëna shteruese për autorët e Statutit të Komunës së Deçanit që u hartua në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e miratuar në Kaçanik më 7 shtator 1990.

Librit i prin dedikimi i autorëve në faqen 5 që i përkushtohet grupit të juristëve: Sali Çekaj, Rrustem Bruqi, Ista Mushkolaj, Zeqir Ramosaj, Isa Demukaj, Xhevdet Lataj, Pashë Kuqi dhe Njazi Hylaj të cilët me mund e sakrifica hartuan Statutin e komunës së Deçanit sipas Kushtetutës së Kaçanikut. Ndërsa më pas në faqen 7 është shkrimi i redaktorit Maxhun Lokaj që titullohet: Në vend të hyrjes.

Monografia Fillimi i zbatimit të Kushtetutës së Kaçanikut në komunën e Deçanit, përveç fjalës së hyrjes ka tri pjesë, përfundimi në shqip dhe rezyrenë në gjuhën angleze, biografite e autorëve Selim D. Lokaj dhe Shkodran Ymeraj, literaturën dhe burimet si dhe dokumentet në të cilat janë mbështetur autorët gjatë hartimit të tekstit.

Në pjesën e parë të monografisë që titullohet Rrjedhat politiko-juridike në Kosovën e fillim viteve 90-ta të shekullit XX, fq. 9-22 autorët që në fillim ofrojnë të dhëna për rrjedhat politiko – juridike në Kosovë dhe në Deçan në fillim të viteve të 90-ta të shek. XX, të dhëna këto që autorët na i sjellin përmes kujtimeve apo burimeve dhe dokumenteve autentike të aktorëve të cilët ishin edhe kreatorë të ngjarjeve që trajtohen. Duke mos lënë anash as masat represive të pushtetit serb ndaj institucionet e Kosovës në përgjithësi dhe ndaj shqiptarëve në veçanti.

Një vend meritore në këtë monografi zë trajtimi deri në detaje i procesit të miratimit të Deklaratës Kushtetuese më 2 korrik 1990 si dhe miratimi i Kushtetutës së Kaçanikut më 7 shtator 1990 nga delegatët e Kuvendit të Kosovës. Në këtë pjesë autorët paraqesin jo vetëm gjendjen e rëndë të shqiptarëve por edhe përkeqësimin e raporteve në mes delegatëve shqiptarë dhe serbë në Kuvendin e Kosovës sidomos në periudhën pas 22 qershorit 1990 kur Kuvendi i kishte mbyllë punimet dhe pasi delegati Ruzhdi Bakalli kishte deklaruar haptazi “Si jemi kurorëzua me Serbinë ashtu edhe shkukurorëzohemi”, pas së cilës kryetari i atëhershëm i Kuvendit të

Kosovës Gjorgje Bozhoviqi ndërpreu mbledhjen e Kuvendit. Hë pas shumë bisedimesh ishte arritur marrëveshja që mbledhja e tri dhomave të Kuvendit të vazhdohet me 2 korrik 1990.

Të dhëna me peshë në këtë kapitull lexuesi do të gjejë për punën e komisioneve të Kuvendit të Kosovës të cilët i ndanë detyrat në hartimin dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes së Kuvendit të cilët nënshkruan Deklaratën Kushtetuese dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në fund të pjesës së parë kujdes të veçantë autorët i kushtojnë kontributit të tre delegatëve deçanas në miratimin e Deklaratës Kushtetuese dhe të Kushtetutës së Kaçanikut. Në mesin e delegatëve të Kuvendit të Kosovës të përbërjes së vitit 1989, nga Komuna e Deçanit ishin: Agush Balaj nga Strellci i Ulët, Fetije Shala nga Prapaqani dhe Zymer Lulaj nga Broliqi. Me 2 Korrik kur u shpall Deklarata Kushtetuese morën pjesë që të tre delegatët deçanas, kurse më 7 shtator Fetije Shala pasi që ishte në Zvicër i pranoi dhe i përkrahu vendimet e Kuvendit të Kosovës.

Në vazhdim autorët nuk e lënë pa e potencuar faktin se Komuna e Deçanit është Komuna e parë dhe e vetme në Kosovë e cila filloi jetësimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe se në krye të këtij misioni sa të rrezikshëm po aq edhe të shenjtë u vu Shoqata e Pavarur e Juristëve të Kosovës dega në Deçan në krye të së cilës u zgjodh juristi dhe veprimtari i njohur Sali Çekaj ndërsa sekretar u zgjodh Isat Mushkolaj.

Pjesa e dytë titullohet Fillimi i jetësimit të Kushtetutës së Kaçanikut në komunën e Deçanit, fq. 23-44. Kjo pjesë fillon me iniciativën e themelimit të Shoqatës së Pavarur të Juristëve të Kosovës dega në Deçan duke paraqitur historikun e saj që nga këshilli iniciues e deri te pjesëmarrja e anëtarëve në Kuvendin Themelues në maj të vitit 1990 në lokalet e Gjimnazit “Vëllezërit Frashëri” në Deçan ku kishin marrë pjesë rreth 40 jurist të Komunës së Deçanit. Në mesin e mysafirëve pos tjerësh morën pjesë edhe Prof. Dr. Bardhyl Çausi dhe avokati Bajram Kelmendi i pari i zhdukur kure i dyti i vrarë nga policia serbe.

Në rrethana mjaftë të ndërlikuara dhe të vështira Shoqata e Pavarur e Juristëve të Kosovës dega në Deçan pa u hamendur fare mori iniciativën për hartimin e Statutit të Komunës së Deçanit në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Duke sjellë të dhëna për anëtarët e Këshillit iniciues si për Kuvendin e Parë ashtu

edhe për mbledhjet tjera gjatë vitit 1990 ku u caktuan grupet punuese dhe u ndanë detyrat për hartimin e Statutit të Komunës së Deçanit në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Hartimi i Statutit të Komunës së Deçanit sipas Kushtetutës së Kaçanikut dhe struktura e këtij Statuti trajtohen në detaje duke sqaruar dhe duke ia bërë me dije opinionit të gjerë angazhimet dhe detyrat që i kishin ndarë në mes vete autorët që hartuan Statutin. Në bazë të të dhënave që sjellin autorët shihet se Statuti i Komunës së Deçanit është hartuar për 27 ditë gjegjësisht prej 10 tetorit deri më 5 nëntor të vitit 1990. Ata gjithashtu theksojnë se nuk është ruajt asnjë kopje e këtij Statuti për shkak se organet e ndjekjes e kanë konfiskua tërë materialin dhe dokumentacionin pas arrestimit të juristëve. Në pjesën përfundimtare të këtij kapitulli jepen të dhëna dhe ofrohen dokumente relevante, për masat represive të pushtetit serb, për arrestimin dhe dënimin e juristëve deçanas nga ana e gjyqeve serbe të kohës.

Pjesa e tretë e këtij dorëshkrimi titullohet Biografitë e juristëve deçanas aktor kryesor në hartimin e Statutit të Komunës së Deçanit sipas Kushtetutës së Kaçanikut. Në këtë kapitull të kësaj monografie autorët sjellin të dhëna biografike të bollshme deri në detaje për të gjithë juristët deçanas: Sali Çekaj, Rrustem Bruqi, Isat Q. Mushkolaj, Zeqir H. Ramosaj, Isa M. Demukaj, Xhevdet I. Lataj, Pashë S. Kuçi dhe Njazi I. Hylaj disa prej të cilëve si Sali Çekaj e Rrustem Bruqi tani më dëshmorë që u angazhuan dhe kontribuuan në hartimin e Statutit të komunës së Deçanit sipas Kushtetutës të miratuar më 7 shtator 1990 në Kaçanik nga delegatët e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në fund të librit jepet një përfundim i shkurtër në gjuhën shqipe si dhe një rezymë e shkurtër në gjuhën angleze e cila konsiderojmë se ia shton vlerën veprës, sikurse epen edhe biografitë e autorëve si dhe literatura dhe burimet e shfrytëzuara si ato të botuara dhe dokumentet e pa botuara si dhe lista e atyre që kontribuon me deklaratat e tyre

Angazhimi dhe veprimtaria patriotike e juristëve të Deçanit ishte një kontribut i madh për kohën dhe kushtet sado që në atë kohë autorët ndoshta nuk ishin të vetëdijshëm për peshën e madhe dhe për rëndësinë historike të aktiviteteve që po kryenin në shërbim të kombit dhe të shtetësisë së Kosovës.

Historia si mësuese e jetës konstaton faktin e mirënjohur se perandoritë si instrumente shtetërore synim të përhershëm kanë

shtypjen e kombeve. Prandaj ato jo vetëm që nuk i duan lëvizjet nacionaliste dhe çlirimtare por përdorin forma dhe mjete nga më të ndryshmet për të shuar ato që në zanafillën e tyre. Në këtë drejtim as perandoria jugosllave nuk bënte përjashtim nga kjo por përkundrazi ajo me mekanizmat e veta të shumta represive dhe me shumë llojshmërinë e formave nuk la gurë pa lëvizur për të shuar lëvizjen çlirimtare të popullit tonë duke ndërmarrë edhe masat më drastike deri te ato të gjenocidit. Por përkundër masave represive dhe terrorit shtetëror çdo pushteti okupues i vije fundi njëherë e përgjithmonë kështu ndodhi edhe me pushtetin jugosllav përkatësisht me atë serb. Dhe ky fund, i ligjshëm, erdhi vetëm pas organizimit të të gjitha forcave tona kombëtare edhe përmes luftës heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Stili dhe gjuha e rrjedhshme e kësaj monografie është një përparësi e cila e bën veprën me të pranueshme dhe më të kuptueshme për një shtresë më të gjerë lexuesish.

Mendoj se me këtë vepër autorët me sukses kanë arrit qëllimet e synuara duke larë një borxh të madh, duke i përjetësuar dhe duke i shpëtuar nga pluhuri i harresës angazhimet dhe veprimet patriotike të grupit të juristëve të Deçanit dhe jo vetëm të tyre për jetësimin e Kushtetutës së Kaçanikut dhe njëherit duke ua bërë të mundshme jo vetëm gjeneratave të tanishme por edhe gjeneratave të ardhshme që të mësojnë dhe ta kujtojnë e mos ta harrojnë kurrë një periudhë shumë të rëndësishme të historisë sonë dhe përpjekjet e gjeneratave për të ardhur këtu ku jemi sot në Kosovën e lirë shtet i pavarur dhe sovran për të cilën populli i Kosovës kishte votuar në mënyrë plebishitare qysh në Referendumin e shtatorit të vitit 1991.

Dhe krejt në fund po e përfundoj këtë recension me konstatimin se nëse aktorët që hartuan statutin e komunës së Deçanit në bazë të Kushtetutës së Kaçanikut përkatësisht të Kushtetutës të Republikës së Kosovës kryen një obligim po aq kombëtar dhe me rëndësi historike për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme.

